

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 09. janar 2003, unë Blerina Muca, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studiova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. James Reiff në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA për depozitimin e akteve të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria anonime PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA është person juridik i së drejtës shqiptare i regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 25341, datë 2 mars 2001, me aksionerë: 1) shoqërinë Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe), shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Anglisë dhe Uellsit, e themeluar më 24 Shkurt 1998 me Numër regjistri 3516266; 2) shoqërinë Opportunity Transformation Investments Inc. shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Illinois, e themeluar më 19 Qershor 2000; dhe 3) Fondacioni Shqiptar i Misionit Menonit, një fondacion shqiptar, i organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, themeluar më 16 Prill 2002, me Vendimin nr. 39, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Më datë 15 dhjetor 2003 është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA, e cila ka vendosur:

- Të miratojë shitjen e 19,258 aksioneve të zotëruara nga aksioneri Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) tek aksioneri tjetër i shoqërisë, Opportunity Transformation Investments Inc.
- Me shitjen e të gjithë aksioneve që zotëron në shoqërinë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA, aksioneri Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) largohet nga shoqëria;
- Me blerjen e aksioneve të Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) nga aksioneri Opportunity Transformation Investments Inc. struktura e aksionerëve të shoqërisë "PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI" SHA, do të jetë si më poshtë:
 - **Opportunity Transformation Investments Inc.** zotëron 41,748 aksione që i korrespondojnë 99,5 për qind të kapitalit aksioner;
 - **Fondacioni Shqiptar i Misionit Menonit**, zotëron 210 aksione që i korrespondojnë 0,5 për qind të kapitalit aksioner.

Më datë 15 dhjetor 2003 është lidhur Kontrata e Shitjes së Aksioneve ndërmjet aksionerit Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) dhe aksionerit tjetër të shoqërisë Opportunity Transformation Investments Inc.

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA të datës 15 dhjetor 2003 për miratimin e shitjes së 19,258 aksioneve të zotëruara nga aksioneri Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) tek aksioneri tjetër i shoqërisë, Opportunity Transformation Investments Inc. Me shitjen e të gjithë aksioneve që zotëron në shoqërinë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA, aksioneri Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) largohet nga shoqëria. Me blerjen e aksioneve të Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe), nga aksioneri Opportunity Transformation Investments Inc. struktura e aksionerëve të shoqërisë "PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI" SHA, do të jetë si më poshtë:
 - **Opportunity Transformation Investments Inc.** zotëron 41,748 aksione që i korrespondojnë 99,5 për qind të kapitalit aksioner;
 - **Fondacioni Shqiptar i Misionit Menonit**, zotëron 210 aksione që i korrespondojnë 0,5 për qind të kapitalit aksioner.
- Depozitimin e Kontratës së Shitjes së Aksioneve ndërmjet aksionerit Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) dhe aksionerit tjetër të shoqërisë Opportunity Transformation Investments Inc, datë 15 dhjetor 2003.
- Urdhërohet zyra e Regjistrat Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

BLERINA MUCA

